



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 206/15 prot.,

Datë 17.03.2025

V E N D I M

Nr. 373 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BONUS Sh.p.k” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës ”Nënë Tereza” Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Ankimues:

BOE “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), me NUIS K01730502Ë, me adresë: Rruga Dituria , Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës, & “S.M.O.UNION” Shpk me NUIS J66902042Q.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “BONUS Sh.p.k”, me NUIS K72412009E, me adresë: Tiranë, Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale 8330, Numri i Pasurise 2/60-N11, Volumi 30, Faqe 105.

BOE “C O L O M B O Sh.p.k” (përfaqësues), me NUIS J82916489E, me adresë: Fier, Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67 & “BAJRAMI N” Shpk.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I****Vlerësimi paraprak**

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.11.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruktion i Rrugës ”Nënë Tereza” Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 18.12.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 15.01.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. OE “BONUS Sh.p.k”	55.646.276	I Kualifikuar
2. MELA Shpk	58,830,855	I Skualifikuar
3. BOE C O L O M B O & BAJRAMI N.	61.159.908	I Kualifikuar
4. BOE LIQENI VII & S.M.O.UNION	61.508.752	I Kualifikuar
5. KUPA Shpk	76.271,707	I Skualifikuar
6. ULZA Shpk	76.316.023	I Kualifikuar

II.4. Në datën 16.01.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 3, datë 20.01.2025, ku është shpallur fitues OE BONUS shpk.

II.5. Në datën 22.01.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 206/2025 protokolli, me datë 22.01.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/4999 e BOE “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “BONUS Sh.p.k” dhe BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 206/1 prot., datë 23.01.2025, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret që operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues) & “S.M.O.UNION” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “BONUS Sh.p.k” dhe BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, në procedurën e mësipërme të prokurimit, të parashtruara në ankesën me nr. 206 prot., datë 22.01.2025.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 887/1 prot., datë 27.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 206/2 prot., datë 29.01.2025, me objekt “Shkresë përcjellëse” dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor Vendimi nr. 887 prot., datë 27.01.2025, mbi shqyrtimin e ankesës online me nr. A/2025/4999, sipas së cilit është vendosur **mos pranim** të formularit të ankesës së ankimuesit.

II.8. Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 180/2025 datë 04.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të urdhërojë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar të tyre, nga ana e BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk., në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës”Nënë Tereza”Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.*
2. *Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 10.02.2025.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.8.1.Me shkresën përcjellëse me objekt “Dërgim vendimi” me nr. 206/5 prot., datë 04.02.2025 Komisioni i Prokurimit Publik, iu dërgua me shërbim postar Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 180/2025 datë 04.02.2025 për BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk.

II.9. Me shkresën nr. 206/6 prot., datë 05.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua autoritetit kontraktor Bashkisë Kamëz, që të dërgojë dokumentacionin e plotë fizik të dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “BONUS” SHPK, të njehsuar me origjinalin dhe të numerizuar nga ana e autoritetit kontraktor.

II.10. Me shkresën e datës 10.02.2025, me objekt “Kërkesë për marrje informacione”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr. 206/7 prot., datë 11.02.2025, operatori ekonomik “LIQENI VII” Shpk ka dërguar një kërkesë drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik.

II.11. Me shkresën nr. 1472/1 prot., datë 12.02.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e protokolluar me tonën me nr. 206/8 prot., datë 14.02.2025, në përgjigje të shkresës me nr. nr. 206/6 prot., datë 05.02.2025.

II.12. Me shkresën nr. 206/9 prot., datë 26.02.2025, Komisioni i Prokurimit Publik, iu drejtua Postës Shqiptare sha, duke i kërkuar informacionin që fакton datën e dorëzimit dhe të marrjes së Vendimit të Ndërmjetëm me nr. 180/2025 datë 04.02.2025 drejtuar BOE “Colombo Sh.P.K” (Përfaqësues) & “Bajrami N” Shpk.

II.13. Me shkresën nr. 19 prot., datë 03.03.2025, protokolluar me tonë me nr. 206/10 prot., datë 03.03.2025 me lëndë “Plotësim dokumentacioni”, operatori ekonomik “LIQENI VII” Shpk i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik për marrje të një informacioni më të thelluar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me pretendimet e tij të shprehura në formular ankese.

II.14. Me shkresën nr. 19 prot., datë 03.03.2025, protokolluar me tonë me nr. 206/11 prot., datë 05.03.2025 me lëndë “Plotësim dokumentacioni”, operatori ekonomik “LIQENI VII” Shpk i është drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik për marrje të një informacioni më të thelluar nga autoriteti kontraktor, në lidhje me pretendimet e tij të shprehura në formular ankese.

II.15. Me shkesën nr. 447/1 prot., datë 10.03.2025, protokolluar me tonë me nr. 206/12 prot., datë 11.03.2025 Posta Shqiptare sha ka kthyer përgjigje shkresës me nr. 206/9 prot., datë 26.02.2025.

II.16. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, duke kundërshtuar kualifikimin e BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk Komisioni me Vendimin e Ndërmjetëm KPP 180/2025 datë 04.02.2025 i kërkoj paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 180/2025 datë

04.02.2025, nga BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk., nuk është dërguar asnjë informacion.

BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar, si dhe brenda çdo afati të arsyeshëm ligjor. Referuar pikës 1 të nenit 82 “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj dhe pikës 4 të nenit 94 “4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi” Ligj Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, barra e provës i përket BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, si palë e interesuar në këtë proces, i cili ka dështuar për të sjellë paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këto kushte, duke qenë se BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, si palë e interesuar, ka qenë pasiv dhe jobashkëpunues në dhënien e informacionit të kërkuar, Komisioni nuk do të marrë në shqyrtim pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk. Konkretisht, Komisioni konstaton se pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk mbi kualifikimin e BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, janë pretendime që nuk mund të verifikohen nga burime të hapura. Por është detyre e BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk, që të sjellë dokumentacionin provues. Në korrespondencën e zhvilluar shkresore me Institucionin kompetent Posta Shqiptare sha, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 206/9 prot., datë 26.02.2025, iu drejtua Postës Shqiptare sha, duke i kërkuar informacionin që fakton datën e dorëzimit dhe të marrjes së Vendimit të Ndërmjetëm me nr. 180/2025 datë 04.02.2025 drejtuar BOE “Colombo Sh.P.K” (Përfaqësues) & “Bajrami N” Shpk. Nga informacioni i dërguar nga Posta Shqiptare sha, me shkesën nr. 447/1 prot., datë 10.03.2025, protokolluar me tonë me nr. 206/12 prot., datë 11.03.2025 evidentohet se nga gjurmimi i objektit postar me barkod RR723226505AA, dhe pasi është procesuar në sektorët përkatës është dorëzuar në datën 07.02.2025 të adresuarit të shoqërisë “Colombo” Shpk me adresë Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier.

Posta Shqiptare

postashqiptare.al/#kerko

RR723226505AA

Te dhënat për kodin RR723226505AA

Data	Ngjarja	Zyra	Destinacioni
07-02-2025 10:25 AM	Objekti u dorëzua / Deliver item (ink)	Zyra Postare Fier Qendrore, FIER	
07-02-2025 08:05 AM	Objekti dhene postierit per dorëzim / Handover item to delivery agent	Zyra Postare Fier Qendrore, FIER	
07-02-2025 07:19 AM	Objekti u mor nga thesi per perpunim / Receive item at location (ink)	Zyra Postare Fier Qendrore, FIER	
06-02-2025 20:10 PM	Objekti u mor nga thesi per perpunim / Receive item at location (ink)	Transiti i Brendshem, TIRANA	
06-02-2025 13:10 PM	Pranimi objekti nga klienti / Receive item from customer	Zyra Postare Tirane 6, TIRANA	

Në rastet e shqyrtimit të ankesave nga KPP, kur kjo nga praktika e konsoliduar është treguar proaktive në kërkim të informacionit të deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit në SPE, për tu dorëzuar nga ana e BOE “COLOMBO Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk. Ky i fundit refuzoi bashkëpunimin me KPP, duke bërë të pamundur verifikimin e pretendimeve të ngritura në formular ankese nga BOE “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, në drejtim të deklaratave të bëra nga BOE “Colombo Sh.P.K” (Përfaqësues) & “Bajrami N” Shpk, kur ky i fundit ka dështuar të provojë që përmbush kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, dhe së dyti certifikatat/dëshmitë e kualifikimit të punonjësve, verifikimi i mjeteve të deklaruar. Sa më sipër, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë këtë BOE nga procedura e prokurimit.

III.2. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, duke kundërshtuar kualifikimin e OE “BONUS” Shpk, , me argumentin se: “....Sipas hulumtimeve qe Shoqeria jone ka bere per konkurentet ne treg, Shoqeria “BONUS” sh.p.k nuk e ploteson fare kerkesen per paraqitjen e nje nje Inxhinieri Ndërtimi (profili infrastrukture). Asnje inxhinier qe kjo Shoqeri ka paraqitur nuk eshte i ketij profili....”,

“....Bazuar ne njohjen qe Shoqeria jone ka per konkurentet ne treg, Shoqeria “BONUS” sh.p.k nuk disponon manovratore apo automakiniste sipas kerkesave ne DST pasi nuk disponon manovrator me deshmi te leshuar nga DPSHTRR si dhe nuk disponon teknik gjeodet te pajisur me deshmi shteterore.

Shtuar sa mesiper, Shoqeria “BONUS” sh.p.k gjithashtu nuk disponon fare specialistet e kerkuar si vijon:

- Specialist vendosje bordurash
- Specialist shtrim pllaka trotuari
- Betonues....”, Komisioni vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.7 Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve ne objektin e kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes te specializuar/kualifikuar me arsim te lart dhe te mesem si staf mbeshtetes. Specialistet te shoqerohen me kontrata pune, diplome/ certifikate, Certifikate e vlefshme te sigurimit teknik, te figurojne ne listpagesat e shoqerise për periudhen 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (profili infrastrukture)**
- 1 (një) Inxhinjer pyjesh/Agronom
- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

2.3.8. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe punonjes te specializuar/kualifikuar si me poshte:

- 1 (një) Teknik Ndërtimi
- 1 (një) Teknik Topograf/Gjeodet
- 2 (dy) Hidraulikë
- 2 (dy) Elektracist
- 3 (tre) Karpentierë
- 2 (dy) Hekurkthyes
- 3 (tre) Betonues
- 2 (dy) Specialistë vendosje bordurash**
- 3 (tre) Specialistë shtrim pllaka trotuari
- 1 (një) Specialist të çertifikuar për Shërbime Gjellbërimi (Kopshtarë)**
- 3 (tre) Punëtorë asfalti
- 9 (nëntë) Punëtorë**
- 3 (tre) Manovratorë/Ekskavatoristë
- 2 (dy) Shoferë
- 2 (dy) Automakinistë
- 1 (një) Buldozeris

Në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera :

Specifikoni nëse autoriteti/enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të

operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po	X	Jo	☐
----	---	----	--------------------------

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja :

Ofertuesve për secilin lot, nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e operatorëve të tjerë për plotësimin e kërkesave për kualifikim si më poshtë vijon :

- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DT ;
- Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DT dhe 2.3.2/a deri 2.3.2/e
- **Dëshmi për fuqinë punëtore dhe specialistete tjere të operatorit ekonomik** Stafi inxhinierik dhe specialiste të kërkuar sipas pikës 2.3.3/a dhe 2.3.b të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DT

Ofertuesve, nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën/at, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh dhe stafi inxhinierik (drejtuesit teknik) vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën/at sipas standardeve të kërkuara.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) në përmbushje të kriterit të kualifikimit, si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga ky ofertues me shkresën me nr. 1472/1 prot., datë 12.02.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e protokolluar me tonën me nr. 206/8 prot., datë 14.02.2025, konkretisht ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 8 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “BONUS” SHPK, të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “BONUS” SHPK. Konkretisht, ky operator ekonomik do të mbështetet tek operatori ekonomik “2 N” SHPK, për përmbushje të pikës 2.3.8 të DT, për punonjës elektrikist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “2N” Shpk; do mbështetet tek operatori ekonomik “Gjikuria” SHPK, për përmbushje të pikave 2.3.7 dhe 2.3.8 të DT, për punonjës inxhinier ndërtimi profili strukturist, inxhinier pyjesh, hidraulik, karpentier, spc shtrim pllaka trotuari, eskavatorist, automakinist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “Gjikuria” Shpk; pika 2.3.10 leje mjedisi III.1.A. tipi C; do mbështetet tek operatori ekonomik “Shehu SHPK, për përmbushje të pikës 2.3.7 të DT, për punonjës automakisnist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “Shehu” Shpk; do mbështetet tek operatori ekonomik “IDK Konstruksion” SHPK, për përmbushje të pikës 2.3.7 të DT, për punonjës automakinist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “ IDK Konstruksion” Shpk;

- Deklaratë me datë 18.12.2024 e lëshuar nga shoqëria “Gjikuria” Shpk në cilësinë e subjektit që do të mbështesë subjektin “BONUS” Shpk.
- Shtojcën 8 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Gjikuria” SHPK;
- Deklaratë me datë 18.12.2024 e lëshuar nga shoqëria “Shehu” Shpk në cilësinë e subjektit që do të mbështesë subjektin “BONUS” Shpk.
- Shtojcën 8 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Shehu” SHPK;
- dokumentacion fizik i njehsuar me origjinalin të mjeteve që disponon në përmbushje të kriterit 2.3.7. dhe 2.3.8. të DT;

III.2.3. Në neni 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.2.5. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.6. Në nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta. 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t’i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit. 5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes. 6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.2.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç)operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d)operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh)operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e)operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë)operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f)operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g)operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj)operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.8. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor

mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit. Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.10. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në rastin konkret duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit i cili pretendon se kualifikimi i subjektit fitues "BONUS" SHPK është bërë në kundërshtim me kufizimin e vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, në rastin konkret në: *Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DT ; Licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh, kërkuar sipas pikës 2.3.2 të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DT dhe 2.3.2/a deri 2.3.2/e* **Dëshmi për fuqinë punëtore dhe specialiste tjere të operatorit ekonomik** *Stafi inxhinierik dhe specialiste të kërkuar sipas pikës 2.3.3/a dhe 2.3.b të Kapacitetit teknik të KVK, të shtojcës 7, të DT. Ofertuesve, nuk u lejohet të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi përvoja për të zbatuar kontratën/at, licenca profesionale sipas niveleve për çdo kategori punimesh dhe stafi inxhinierik (drejtuesit teknik) vlerësohen kapacitete të lidhura ngushtë me shoqërinë dhe tepër të rëndësishme dhe të nevojshme për të krijuar bindjen te AK se ofertuesit kanë aftësinë për të zbatuar kontratën/at sipas standardeve të kërkuara.* Nga shqyrtimi dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar aspektet në të cila nuk lejohet mbështetja dhe që kanë të bëjnë me kufizimet e përmendura më sipër. Ndërsa, subjekti fitues "BONUS" SHPK për të përmbushur kriteret e kualifikimit konkretisht: pikat 2.3.7 + 2.3.8 të DT, autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionit fizik të dërguar nga ky ofertues me shkresën me nr. 1472/1 prot., datë 12.02.2025, e protokolluar me tonën me nr. 206/8 prot., datë 14.02.2025, ku nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni fizik, konstatohet se, subjekti fitues "BONUS" SHPK ka dorëzuar Formularin Përmbledhës së Vetdklarimit sëbashku me dokumentacion shoqërues në përmbushje të kriterëve të kualifikimit 2.3.7 +2.3.8, por ka deklaruar katër subjekte mbështetëse, të cilat kanë sjellë respektivisht Formularët Përmbledhës Vetdklarimi, marrveshje e lidhur midis palëve, dokumentacion shoqërues, të cilat bien në kundërshtim me pikën 2.16 të DT ku vetë autoriteti kontraktor referuar edhe dispozitivit të sipërciuar, në rastin e kontratave të punëve, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve

*të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit, siç është rasti në fjalë, ku vetë autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz e ka ndaluar ofertuesin sipas pikës 2.16 në DT. KPP gjykon, se ligjvënësi përmes *lex specialis* por edhe rregullat e prokurimit publik që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit kanë përcaktuar mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për t'u mbështetur në kapacitetet teknike, profesionale dhe ekonomike të subjekteve të tjera ashtu sikurse kanë lënë në diskrecionin e autoriteti kontraktor që të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës ofruesi të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ai me kushtin që ky informacion të publikohet në dokumentet e tenderit. Akoma më tej, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se, operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së ku përcaktohet se “1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave.*

Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”. Si përfundim, nga analiza e fakteve të spërcituara, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor Bashkia Kamzës ka kualifikuar subjektin “BONUS” SHPK në kundërshtim me pikën 2.16 të DT, dhe në këto kushte duhet të marrë masa duke e skualifikura atë.

Për sa më lart, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.3. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, duke kundërshtuar kualifikimin e OE “BONUS” Shpk, , me argumentin se: “....Nepermjet nje kerkimi te thjeshte ne faqen e internetit te Qendres Kombetare te Biznesit, Shoqerise “BONUS” sh.p.k i mungojne kodet 17.09.04 dhe 20.03.04 ne Licencen III.2.B duke mos plotesuar keshtu kriterin numer 2.3.10...”, Komisioni vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.10. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

1. me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve

inerte dhe të ngurta), sëbashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. **Kodet 17 05 04 , 17 09 04, 20 03 04;**

2. Leje mjedisi me kodin III 1 tipi A: Leje e thjeshte mjedisore

III.3.2. Në shtojcën 2 “Lista e Cmimeve sipas zërave të preventivit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KAMEZ
PREVENTIV

OBJEKTI:Rikonstruksion Rruga "Nene Tereza" Laknas						
(L =1700 ml, B =14m, basf= 6m, 2x0.5 kunete,2x2 trotuar)						
	An.	Emertimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
I PUNIME NE RRUGE						
NR.	Nr.An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	3.969	Skarifikim shtrese asfalti ekzistues me makineri	m ²	10200		
2	3.2	Prerje bime te vogla ø ~ 10cm	m ²	305		
3	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m ³	100		
4	3.211	Shtrese çakelli T=20cm	m ²	100		
5	3.212/b	Shtrese stabilizanti t=10cm	m ²	100		
6	3.222/1	Shtrese binderi 1x5 cm	m ²	100		
7	3.224/1	Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri	m ²	10200		
8	2.111	Mure betoni C12/15(themel,xokol betoni)	m ³	619.63		
9	3.288	F.V Hekur betoni I zakonshem Ø > 12 mm	ton	9.69		
10	3.558	elektrike prej betoni perfshire linjat dhe aksesoret)	cope	13		
11	3.581	Mbingritje h=0.5 m, Pusete ekzistuese UZ Ø 1.0 m +pastrim e llumrave me makineri+transport	cope	34		
12	2.426/2	Prishje mure me blloqe + transport	m ³	560		
13	3.949/1	Vizime me boje bikomponente 15cm(shirita gjatesor dhe anesor).Termoplastike (paste) anesoret + aksi+vijeizime kembesoret	ml	4250		
14	3.934/1	F.v. Tabele rrethi "detyrim" normal me D = 60	cope	30		
15	An3.966.	Shkulje+mbjellje pemesh ekzistuese	cope	13		
16	3.643	Mbjellje bari	m ²	100		
17	3.643/a	F.V. Dhe' vegjetal per mbushje (brezat e gjelber)	m ³	57		
18	An3.164/6t	Vendosje tuba te brinjezuar HDPE d=600 mm-1500mm	ml	170.0		
SHUMA I						
II PUNIME NE KUB						
NR.	Nr.An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	3.139	Germim dheu me eskavator	m ³	1360		
2	3.158/5a	Transport dheu me auto 5km	m ³	1360		
3	3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m ³	1030		
4	3.164/1t	F.V. tuba te Brinjezuar SN-8 d=315 mm (perfshire reren per mbrojtjen e tubit)	ml	3332		
5	2.262/4	Shtrese betoni c 16/20Kunete betoni M - 200	m ³	170		
6	2.342	Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	113		
SHUMA II						
III PUNIME TROTUARE(2x2m dy ane) 4480						
NR.	Nr.An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	3.139	Germim dheu me eskavator	m ³	280		
2	3.158/5a	Transport dheu me auto 5km	m ³	280		
3	3.164/1b	Mbushje me çakell shkembor	m ²	364		

4	3.208	Shtrese çakelli t=10cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri	m ²	4480		
5	3.212/b	Shtrese stabilizanti ne trotuar T=10cm	m ²	4480		
6	3.616/9	FV Bordura betoni 15x25 cm	ml	2800		
7	2.262/4	Beton per fiksime bordure C16/20	m ³	84		
8	2.262/4	plaka trotuari	m ²	4480		
		SHUMA III				
IV		PUNIME NE KUZ(L=1700ml)				
NR.	Nr.An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	3.139	Germim dheu me eskavator	m ³	6715		
2	3.158/5a	Transport dheu me auto 5km	m ³	6715		
3	3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m ³	2800		
5	3.164/1t	F.V. tuba te Brinjezuar SN-8 d=315 mm (perfshire reren per mbrojtjen e tubit)	ml	0		
6	2.599	F.V. pusete shkarkimi 100x100, h=150, me kapak gize	cope	68		
		SHUMA IV				
V		PUNIME PER NDRICIMIN				
NR.	Nr.An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	3.654/1	F.V. Tub korrogato Ø80 per telefonine	ml	3400		
2	3.654/1	F.V. Tub korrogato Ø80 per elektrikun, ndricimin	ml	3400		
3	3.17	F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	cope	136		
4	An-19	F.v puseta betoni me kapak gize 80x80x100mm	cope	8		
5	3.139	Germime dheu me ekskavator me goma	m ³	255		
6	3.158/5a	Transport dheu me auto 5km	m ³	255		
7	2.261	Mbushje me rere	m ²	136		
8	3.353	Mbushje me shkemb te germuar me pare	m ³	119		
		SHUMA IV				
VI		PUNIME PER GJELBERIMIN				
NR.	Nr.An	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI	VLERA
1	3.619/a	FV Bordura betoni 6x20 cm	ml	595		
		SHUMA V				
		TOTALI				
		TVSH 20%				
		TVSH TOTALE				

Shenim: Preventivi eshte hartuar ne baze te VKM nr.216, date 13.04.2023

III.3.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “BONUS” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Licencë LN-5704-05-2023, datë 09.05.2023 Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Transport i mbetjeve inerte, dhera ose shtufë, që gjenerohen nga aktiviteti i ndërtimit”.

III.3.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “*Parime të përgjithshme*” të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. *Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. *Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.3.5. Neni 21 pika 1 “*Autoriteti ose enti kontraktor*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

Në nenin 77 “*Kërkesat për kualifikim*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.6. Në nenin 39 pika 6 germa a) “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

III.3.7. Në seksionin “Kategoria III.2. “ Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: “ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.3.8. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, në nenin 1 dhe 2 “Qëllimi dhe Objekti”, parashikohet shprehimisht:

“Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës”. Ky ligj përcakton:

- a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;
- b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.”

III.3.9. Në shtojcën 1, pika 17 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 402, Datë 30.06.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, përcaktohet: “17 Mbetje Nga Ndërtimet Dhe Prishjet (Përfshi Dhera Të Gërmuara Nga Zona Të Kontaminuara)”.

17 01	Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika	17 01 01	Beton
17 01 02	Tulla		
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika		
17 01 06*	Përzierje ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe qeramikës që përmbajnë substance të rrezikshme		
17 01 07	Përzierje të betonit, tullave, tjegullave dhe qeramikës, të tjera nga ato të përmendura në 17 01 06		
17 02	Dru, qelqe dhe plastika		
17 02 01	Dru		
17 02 02	Qelqe		
17 02 03	Plastikë		
17 02 04*	Dru, qelq dhe plastika që përmbajnë substancë të rrezikshme	17 03	
	Përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të ziftit		
17 03 01*	Përzierje bituminoze që përmbajnë zifte qymyri		
17 03 02	Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01	17 03	
03*	Zifte qymyri dhe katrane		
17 04	Metale (përfshi dhe aliazhet e metaleve)	17 04 01	Bakër, bronx, tunxh
17 04 02	Alumin		
17 04 03	Alumb		
17 04 04	Zink		
17 04 05	Hekur dhe çelik		
17 04 06	Kallaj		
17 04 07	Metale të përziera		
17 04 09*	Mbetje metalore të kontaminuara me substanca të rrezikshme		
17 04 10*	Kabllo që përmbajnë naftë, bitum apo substanca të tjera të rrezikshme		
17 04 11	Kabllo të tjera nga ato të përmendura në 17 04 10		
17 05	Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)		
17 05 03*	Dhera dhe gurë që përmbajnë substancë të rrezikshme		
17 05 04	Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03	17 05	
05*	Balta që përmbajnë lëndë të rrezikshme		
17 05 06	Balta, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 05		

17 05 07*	Çakëll që përmban substanca të rrezikshme
17 05 08	Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07 17 06 Materiale izoluese dhe materiale ndërtimi me azbest 17 06 01* Material izolimi që përmban azbest
17 06 03*	Material izolimi që konsistojnë ose përmbajnë substanca të rrezikshme
17 06 04	Materiale izolimi të tjera nga ato të përmendura në 17 06 01 dhe 17 06 03
17 06 05*	Materiale ndërtimi që përmbajnë asbest
17 08	Materiale ndërtimi me gips
17 08 01	Materiale ndërtimi me gips që janë të kontaminuara me substanca të rrezikshme
17 08 02	Materiale ndërtimi me gips, të tjera nga ato të përmendura në 17 08 01
17 09	Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve
17 09 01*	Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë merkur 17 09 02* Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB
17 09 03*	Mbetje nga ndërtimi dhe të prishjeve, duke përfshirë mbetjet e përziera që përmbajnë substanca të rrezikshme
17 09 04	Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03.

20 MBETJET URBANE (MBETJET SHITËPIAKE DHE TREGTARE, MBETJE INDUSTRIALE E INSTITUCIONALE TË NGJASHME) PËRFSHIRË FRAKSIONET E MBLEDHURA VEÇMAS

20 03 04 Llumra nga gropat septike

III.3.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik "BONUS" SHPK, Komisioni konstaton, se ky operator ekonomik ka ngarkuar në SPE dokumentacionin - *Licencë LN-5704-05-2023, datë 09.05.2023 Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë "Transport i mbetjeve inerte, dhera ose shtufë, që gjenerohen nga aktiviteti i ndërtimit"*, për vërtetueshmërinë e plotësimi të kriterit të vecantë të kualifikimit pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik në shtojcën 7. Referuar pretendimit të operaroit ekonomik ankimes mbi kualifikimin e ofertuesit "BONUS" SHPK ku pretendon se *i mungojne kodet 17.09.04 dhe 20.03.04 ne*

Licencen III.2.B duke mos plotesuar keshtu kriterin numer 2.3.10, Komisioni Prokurimit Publik gjykon se, përcaktimi i autoritetit kontraktor, se operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesin Licencë me Kodin III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta”, është një kërkesë e drejtë dhe në përpjestim me objektin e kontratës zërat e punimeve të parashikuar në preventiv, si dhe me legjislacionin e fushës përkatëse konkretisht në Vendimin Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve” Tipat e mbetjeve në katalog” pika 17 në të cilën përcaktohet se “17 Mbetje Nga Ndërtimet Dhe Prishjet (Përfshi Dhera Të Gërmuara Nga Zona Të Kontaminuara)”. Ndërkohë që referuar preventivit në shtojcën 2 konstatohet se, zërat e punimeve janë zëra ndërtimi, konkretisht punime prishje, punime gërmimi, punime ndërtimi, punime shtresash, etj, nga veprimtaria e të cilave lindin mbetje jo urbane por mbetje inertesh të cilat sipas VKM Nr. 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, ato kategorizohen në pikën 17 “Mbetje nga ndërtimet dhe prishjet (përfshin dhera të gërmuara nga zona të kontaminuara)”, në të cilin evidentohen edhe kodet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në hartimin këtij kriteri, pra kodet 17 05 04, 17 09 04 dhe 20 03 04. Në këtë kontekst përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor të një kriteri i cili lidhet plotësisht me objektin e kontratës dhe që i shërben realizimit të kontratës, sjell si pasojë qartësi dhe përcaktim të dokumentit konkret tek operatorët ekonomik, në lidhje me mënyrën mënyrën e plotësimit të këtij kriteri nga ana e tyre, por dhe të komisionit vlerësimit të ofertave duke bërë kështu totalisht të qartë mënyrën e vlerësimit të kësaj procedurë prokurimi. Një ndër parimet kryesore të LPP-së është ai i mosdiskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit. Qëllimi në vetvete i LPP-së është trajtimi i barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në proceduar e prokurimit. Në rastin konkret kriteri i mësipërm e ka vendosur në kushte të barabarta procesin e vlerësimit të ofertave, pra është e qartë se si do të konsiderohet i përmbushur kapaciteti teknik nëse do ti referohemi shtojcës 2 të DST në të cilën parashikohen zërat e punimeve, pra operatorët do të duhet të paraqesin Licencë III.2.B “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), sëbashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e cila sipas VKM 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”, pika 17 përfshin mbetjet që do të krijohen nga zërat e parashikuar të punimeve në shtojcën 2 të DST. Në këtë kuadër KPP gjykon, se përcaktimi i kriterit në pikën 2.3.10 është në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës, zërat e parashikuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 2 të dokumentave standarte të tenderit, e rrjedhimisht në përputhje dhe me dispozitat ligjore të sipërcituara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar për përmbushjen e këtij kriteri, KPP konstataon se subjekti “BONUS” SHPK ka dorëzuar - Licencë LN-5704-05-2023, datë 09.05.2023 Kodi III.2.B, emërtimi përshkrues i veprimtarisë “Transport i mbetjeve inerte, dhera ose shtufë, që gjenerohen nga aktiviteti i ndërtimit”, shoqëruar me akt-miratimi nr. 507 K. Nr.49, ku evidentohet që është i përfshirë kodi 17 05 04, por mungojmë kodet 17 09 04 dhe 20 03 04.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore

në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vendosur. Sa më sipër, KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar dokumentet e tenderit të mësipërm në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se kriteret e kualifikimit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe t’i japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik “BONUS” SHPK me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se është i pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për pajisjen me licensën e kërkuar sipas pikës 2.3.10. Sa më sipër, KPP sqaron, se mos plotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “BONUS” SHPK nuk ka dorëzuar licensën e kërkuar përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, kërkesë kjo e cila nuk është plotësuar nga ana e operatorit ekonomik “BONUS” SHPK.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, duke kundërshtuar kualifikimin e OE “BONUS” Shpk, , me argumentin se: “....Sipas bashkepunimit qe ne kemi me Shoqerite e Sigurimeve dhe informacioneve qe shkembejme me ta na rezulton se Shoqeria “BONUS” sh.p.k ka paraqitur mjete te cilave i mungojne dokumente te kerkuara ne DST si pershembull:

- Autobetoniere me targe AB338MH: mungon certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS)
 - Automjet me targe AB403PK: mungon certifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS)
 - Automjet me targe AHMT80: mungon siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit
- Sa mesiper Shoqeria “BONUS” sh.p.k nuk ka rrespektuar kriterin 2.3.13.

Sipas hulumtimeve qe Shoqeria jone ka bere per konkurentet ne treg, Shoqeria “BONUS” sh.p.k nuk i disponon fare mjetet e kerkuara si vijon:

- Minieskavator cope 1
- Frezë asfalti dhe betoni me karrel ngarkimi për kanale cope 1
- Dedektor linjash elektrike (kablllore) dhe ujësjellësi cope 1
- Frezë për skarifikim asfalti cope 1
- Makineri me pajisje për prerje bimësh cope 1
- Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 Ton cope 2

Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash cope 1 nga 2 qe kerkohen.”, Komisioni vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.13. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.13. Operatori Ekonomik, per realizimin e kontrates, duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet emeposhtme:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës ≥ 20 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
3	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
4	Kamion me vinç	1 copë	Në pronësi ose me qira
5	Kamionçina me kapacitet 1-5 Ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
6	Vinç me kosh për punime ne lartësi	1 copë	Në pronësi ose me qira
7	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	2 copë	Në pronësi ose me qira
8	Rrul me vibrim (kompresor) për ngjeshje asfalti	2 copë	Në pronësi ose me qira
9	Fadrome me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
10	Eskavator me zinxhir + çekiq	1 copë	Në pronësi ose me qira
11	Eskavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qira
12	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
13	Minieskavator	2 copë	Në pronësi ose me qira

14	Grejder me goma	1 copë	Në pronësi ose me qira
15	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qira
16	Autobitumatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qira
17	Autobot Uji	1 copë	Në pronësi ose me qira
18	Autobetonierë	2 copë	Në pronësi ose me qira
19	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
20	Deflektometer	1 copë	Në pronësi ose me qira
21	Makineri për vijezim rruge	1 copë	Në pronësi ose me qira
22	Betonierë kantieri	2 copë	Në pronësi ose me qira
23	Depozitë uji ≥ 1000 litra	2 copë	Në pronësi ose me qira
23	Betoforma	300 m ²	Në pronësi ose me qira
25	Matrapik	2 copë	Në pronësi ose me qira
26	Vibrator betoni (njëri thellësie)	2 copë	Në pronësi ose me qira
27	Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator)	1 copë	Në pronësi ose me qira
28	Nivelues (helikopter) betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
29	Dedektor linjash elektrike (kabllore) dhe ujësjellësi	1 copë	Në pronësi ose me qira
30	Gjenerator ≥ 3.5 kë	1 copë	Në pronësi ose me qira
31	Freze për skarifikim asfalti	1 copë	Në pronësi ose me qira
32	Freze asfalti dhe betoni me karrel ngarkimi për kanale	1 copë	Në pronësi ose me qira
33	Kontenjer (zyre)	1 copë	Në pronësi ose me qira
34	Makineri me pajisje për prerje bimësh	1 copë	Në pronësi ose me qira
35	Makinë teknologjike për pastrim puseta ekzistuese të kanalizimeve, vetëshkarkuese me kazan të mbyllur për transport mbetjesh të ndryshme	1 copë	Në pronësi ose me qira
36	Sondë për zhblllokim dhe pastrim të kanalizimeve ekzistuese dhe tubacioneve të ndryshme.	1 copë	Në pronësi ose me qira
37	Impiant Betoni (i pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
38	Fabrikë Asfalti (e pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
39	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi

Mjete dhe pajisje të mbrojtëse në punë:

- Kokore mbrojtëse 53 copë
- Jelekë 53 copë
- Fikse Zjarri 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën 4 copë
- Tabela Sigurimi Teknik 20 copë
- Tabela rrugore (devijim, punime etj) 8 copë
- Kutitë (komplet) e Ndhmës së shpejtë 6 copë
- Semafor kantieri 2 copë

Kriteri i mesiperm konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipashtojcës 8.

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtëm :

Për mjetet që janë në pronësi, duhet të paraqitet :

- a) dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) foto të mjetit ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*
- f) çertifikatë transporti*

Kur janë me qera, duhet të paraqitet :

- a) kontrata e qerasë;*
- b) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);*
- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);*
- d) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;*
- e) foto ku të evidentohen qartësisht të dhënat specifike të tij.*
- f) çertifikatë transporti*

Për mjetet apo pajisjet e tjera që nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet të paraqesë kontratë noteriale të blerjes ose fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit dhe foto të tyre.

Për impiantin e prodhimit të inerteve, asfaltit dhe betonit;

- a) Në rastin në pronësi ose me qira duhet të paraqiten Akt-Miratimin dhe leje mjedisore QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që vërteton pronësinë.*
- b) Në rastin kur është me kontratë furnizimi/bashkëpunimi duhet të paraqitet kontrata e furnizimit/bashkëpunimit.*

(KVO do të verifikojë nëpërmjet QKB nëse impianti i prodhimit të inerteve, asfaltit ose betonit është i pajisur me licensë 3.1.B, në rast të kundërt OE do të skualifikohet).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) në përmbushje të kriterit të kualifikimit, si dhe referuar edhe dokumentacionit fizik të dërguar nga ky ofertues me shkresën me nr. 1472/1 prot., datë 12.02.2025, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e protokolluar me tonën me nr. 206/8 prot., datë 14.02.2025, konkretisht ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 8 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “BONUS” SHPK, të firmosur dhe vulosur, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “BONUS” SHPK. Konkretisht, ky operator ekonomik do të mbështetet tek operatori ekonomik “2 N” SHPK, për përmbushje të pikës 2.3.8 të DT, për punonjës elektrikist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “2N” Shpk; do mbështetet tek operatori ekonomik “Gjiguria” SHPK, për përmbushje

të pikave 2.3.7 dhe 2.3.8 të DT, për punonjës inxhinier ndërtimi profili strukturist, inxhinier pyjesh, hidraulik, karpentier, spc shtrim pllaka trotuari, eskavatorist, automakinist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “Gjiguria” Shpk; pika 2.3.10 leje mjedisi III.1.A. tipi C; do mbështetet tek operatori ekonomik “Shehu SHPK, për përmbushje të pikës 2.3.7 të DT, për punonjës automakinist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “Shehu” Shpk; do mbështetet tek operatori ekonomik “IDK Konstruksion” SHPK, për përmbushje të pikës 2.3.7 të DT, për punonjës automakinist, mjetet dhe pajisjet e pikës 2.3.13 të DT të listuara në FPV si dhe në FPV të “IDK Konstruksion” Shpk;

- Deklaratë me datë 18.12.2024 e lëshuar nga shoqëria “Gjiguria” Shpk në cilësinë e subjektit që do të mbështesë subjektin “BONUS” Shpk.
- Shtojcën 8 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Gjiguria” SHPK;
- Deklaratë me datë 18.12.2024 e lëshuar nga shoqëria “Shehu” Shpk në cilësinë e subjektit që do të mbështesë subjektin “BONUS” Shpk.
- Shtojcën 8 Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik “Shehu” SHPK;
- dokumentacion fizik i njehsuar me origjinalin të mjeteve që disponon në përmbushje të kriterit 2.3.13 të DT;

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.4. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.4.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Neni 92 pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.*

III.4.6. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.4.7. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në*

vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

III.4.8. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve³ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

³ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

h)operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁴. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.4.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga

autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Nisur nga pretendimet e BOE ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik "BONUS" SHPK konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në Pjesa I, pika B, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik "BONUS" SHPK. Konkretisht, tek subjektet "2N" SHPK; "Gjiguria" Shpk; "Shehu" Shpk dhe "IDK Konstruksion" Shpk. Nga shqyrtimi, i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik i shpallur fiues edhe nga dok origjinal i OE "BONUS" SHPK i dorëzuar nga AK me vulë të institucionit, konstatohet, se ky i fundit për subjektet "2N" SHPK; "Gjiguria" Shpk; "Shehu" Shpk dhe "IDK Konstruksion" Shpk, si subjekte mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet, ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të subjekteve "2N" SHPK; "Gjiguria" Shpk; "Shehu" Shpk dhe "IDK Konstruksion" Shpk me Deklaratat respektive. Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit", në pjesën e fundit përcaktohet, se "në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës". Gjithashtu ka dorëzuar edhe dokumentacion fizik i njehsuar me origjinalin të mjeteve që disponon në përmbushje të kriterit 2.3.13 të DT, në lidhje me vërtetueshmërinë e plotësimit të kriterëve të kualifikimit të vetëdeklaruar në shtojcën 8, ku deklarohet mjetet dhe makineritë, referuar kriterit të parashikuar në pikën 2.3.13 të dokumenteve standarde të tenderit operatori ekonomik BONUS SHPK ka deklaruar në shtojcë (Llojin e mjetit, Targën e mjetit, Nr. Lejes qarkullimit të mjetit, Nr. Shasisë së mjetit, Nr. Kontratës Qirasë, Afati i Kontratës Qerasë, duke evdidentuar:

Nr	Lloji i makinerive	Sasia	Statusi	Dokumentacion shoqërues
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 Ton	2 copë	Në pronësi	Mjeti me targa AA 371 LA, me nr. Leje qarkullimi TRDA0357915, certifikat pronësie, certifikata e vlefshme e kontrollit teknik SGS, polica sigurimit e vlefshme, taksat vjetore, certifikat për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet, kontratë blerje, foto, Mjeti me targa AA104 SD, nr. Lejes qarkullimit TRDA3372317, certifikata e

				vlefshme e kontrollit teknik SGS, polica sigurimit e vlefshme, taksat vjetore, certifikat për transpot mallrash brenda vendit për llogari të vet, kontratë blerje, foto,
7	Rrul me vibrim për ngjeshje shtresash	2 copë	Subjekt mbështeteës	Mjeti në pronësi Bomag me nr. Shasie 75820095, Mjeti Dynapac CA602D, NR serie 71421244, Subjekti mbështetes GJIKURIA shpk
13	Minieskavator	2 copë	Në pronësi	Mjeti me targa YANMAR B 50, nr. Shasie 65126, me faturë nr. 1114/2020 Mjeti me targa CATERPILAR 305 CCR, nr. Shasie CAT0305CEHËJ00886 me faturënr. 12/2020
14	Grejder me goma	1 copë	me qira	Mjeti me targa AHMT80, me qera Nr.rep:535 Nr.kol:222, Nga data 16.12.2024 deri ne perfundim te kontrates, leje qarkullimi, certifikata e vlefshme e kontrollit teknik SGS, foto dhe Polica e sigurimit është e skaduar
18	Autobetonierë	2 copë	Subjekt mbështeteës	Mjeti me targa AB338MH, me nr leje qarkullimi PED00496323, IVECO MAGIRUS_Subjekti mbështetes Shehu shpk, e vlefshme certifikata e e kontrollit teknik SGS, polica sigurimit e vlefshme, taksat vjetore, certifikat për transpot mallrash brenda vendit për llogari të vet, foto, Mjeti me targa AB261AL, me nr leje qarkullimi PED0033732, Astra_Subjekti mbështetes Shehu shpk, certifikata e vlefshme e kontrollit teknik SGS, polica sigurimit e vlefshme, taksat vjetore, certifikat për transpot mallrash brenda vendit për llogari të vet, foto
29	Dedektor linjash elektrike (kabllore) dhe ujësjellësi	1 copë	Subjekt mbështeteës	Fature me tvsh nr. 0260033, date 25.06.2019, Subjekti mbështetes GJIKURIA shpk

31	Frezë për skarifikim asfalti	1 copë	Subjekt mbështeteës	Ref. Dog. Nr.m 29018 dt. 04.04.2018, Subjekti mbështetes GJIKURIA shpk
32	Frezë asfalti dhe betoni me karrel ngarkimi për kanale	1 copë	Subjekt mbështeteës	Fature me tvsh Nr. 805 , date 07.02.2024, Subjekti mbështetes GJIKURIA shpk
34	Makineri me pajisje për prerje bimësh	1 copë	Subjekt mbështeteës	Fature Nr. 0109146724, dt. 01.04.2014, Subjekti mbështetes GJIKURIA shpk
35	Makinë teknologjike për pastrim puseta ekzistuese të kanalizimeve, vetëshkarkuese me kazan të mbyllur për transport mbetjesh të ndryshme	1 copë	me qira	Mjeti me targa AB403PK, me qera Nr.rep:534 Nr.kol:221, Nga data 16.12.2024 deri ne perfundim te kontrates, leje qarkullimi, polica sigurimit e vlefshme, foto dhe mungon certifikata e vlefshme e kontrollit teknik SGS

III.4.10. Referuar sa më sipër KPP gjykon, se operatori ekonomik në lidhje me deklarin e të dhënave të mjeteve, nga verifikimi i shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” rezulton se e ka përmbushur kriterin e veçantë të kualifikimit të parashikuar në pikën 2.3.13. Për sa i përket mjeteve të pretenduara nga operatori ekonomik ankimes që nuk disponojnë dokumentacionin të rregullt sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, operatori ekonomik “BONUS” SHPK ka deklaruar duke plotësuar të gjitha fushat e kërkuara në tabelën e mjeteve me qera/pronësi, tek seksioni respektiv të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur si dhe autoriteti kontraktor ka dërguar dokumentacionit fizik të njehsuar me origjinalin e dorëzuar nga ana e subjektit fitues shoqëruar me dokumentacion plotësues. KPP gjykon, se nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “BONUS” SHPK rezulton, se

1. Grejder me goma: Mjeti me targa AHMT80, me qera Nr.rep:535 Nr.kol:222, Nga data 16.12.2024 deri ne perfundim te kontrates, leje qarkullimi, certifikata e vlefshme ekontrollit teknik SGS, foto dhe Polica e sigurimit është e skaduar;
2. Makinë teknologjike për pastrim puseta ekzistuese të kanalizimeve, vetëshkarkuese me kazan të mbyllur për transport mbetjesh të ndryshme: Mjeti me targa AB403PK, me qera Nr.rep:534 Nr.kol:221, Nga data 16.12.2024 deri ne perfundim te kontrates, leje qarkullimi, polica sigurimit e vlefshme, foto dhe mungon certifikata e vlefshme e kontrollit teknik SGS.

KPP gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “BONUS” SHPK, ka provuar se nuk disponon mjetet e kërkuara sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), & “S.M.O.UNION” Shpk, duke kundërshtuar kualifikimin e OE “BONUS” Shpk, , me argumentin se: “....Perfundimisht duke patur parasysh nje shoqeri te re dhe te pa konsoliduar ne punet publike dhe pa nje numer te madh drejtuesish teknike ne license mendojme se shoqeria ben deklarime jo te sakta duke e perseritur te njejtin drejtues teknik ne

objekt gje e cila eshte e pa rregullt,eshte deklarim i rreme dhe nje proces i cili eshte i pa mundur pasi i njeiti drejtues teknik nuk mund te mbuloje njekohesisht me shume se nje objekt me kohe te plote.

Ky dyshim lind per faktin se objektet jane akoma ne vazhdim saktesisht momentalisht per mbi 6 muaj sejcili. Si rezultat, mendojme se edhe ne kete rast ka nje arsye me shume qe kjo shoqeri te skualifikohet nga gara per te cilen ne ankimojme pasi angazhimi i inxhinierve te deklaruar si drejtues teknike ne me shume se nje objekt ne te njejten kohe bie ne kundërshtim me Udhezimin Nr. 2 , datë 13.5.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”.

... ”, Komisioni vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.7. “Kriteret e veçanta të kualifikimit” i dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.6. *Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:*

- a) Librezë pune;*
- b) Kontratë pune e vlefshme;*
- c) Diplomë.*

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunitit).

III.52. Në në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”

III.5.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “BONUS” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “BONUS” SHPK, me datë 18.12.2024; ku në Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit: B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, është deklaruar Z.Ramis Sulaj (Drejtues teknik)me profesion inxhinier Ndertimii punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin, Inxhinier Ndertimi, i perfshire ne Licencen e Shoqerise, i pajisur me diplome Nr. 6343- B, dt. 28.05.1981, leshuar nga Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimi, Universiteti i Tiranes;

-Deklaratë për Drejtuesin Teknik datë 18.12.2024 ku sipas së cilës: *Deklarate e operatorit ekonomik Bonus Shpk pjesemarres ne proceduren publike te prokurimit qe do te zhvillohet date 18.12.2024, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamez me objekt : Rikonstruksion i Rrugës “Nënë Tereza”Laknas, me Fond limit: 77,878,432.50 leke pa tvsh. Unë, Fuat Borishi,*

Administratori i shoqërisë "BONUS" sh.p.k ne permbushje te kriterave per kualifikim per piken 2.3.6. deklaroj se : Ing. Ndertimit Z. Ramis Sulaj eshte Drejtuesi Teknik i punimeve ne objekt, i perfshire ne licensen e shoqerise, nuk eshte i angazhuar ne kontrata te tjera dhe do te jete i pranishem gjate gjithe kohes qe do te kryhen punimet ne objekt.

-Licenca e operatori ekonomik "BONUS" SHPK, ku Z. Ramis Sulaj është Drejtuesi Teknik i perfshire ne licensën e shoqërisë;

-Kontratë pune individuale ndërmjet subjektit "BONUS" Shpk dhe Z. R. S. Me nr. Rep 306, nr. Kol.140 datë 13.09.2023 në pozicionin e Drejtuesit Teknik, inxhinier ndërtimi.

-Diplomë me nr. S343-B, profili inxhinier ndërtmi për ndërtime civile industriale ura, me nr. Regj. 1228 datë 28.05.1981, shoqëruar me dokumentacion licencë individuale me nr. Z. 0558/5, librezë pune, Cv.

III.5.4. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme

njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.5.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.5.6. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht : “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.5.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve⁵ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërket për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

⁵ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

i)operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j)informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k)operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të V, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike⁶. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7.Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.5.8. Ligji Nr. 120/2020 “Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Ligjin Nr.8402, Datë 10.09.1988, “Për Kontrollin Dhe Disiplinimin E Punimeve Të Ndërtimit” Të Ndryshuar” parashikon se: Neni 3 “Përkufizime” pika 12. “drejtues teknik” është personi fizik, i përcaktuar në licencën e shoqërisë, i cili është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit

“Neni 8/1 Drejtuesi Teknik 1. drejtuesi teknik është solidarisht përgjegjës me zbatuesin e punimeve për të realizuar punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin,

kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. 2. drejtuesi teknik nuk mban përgjegjësi solidare, sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm kur njofton menjëherë inspektoratin vendor të mbrojtjes së territorit ose, sipas rastit, inspektoratin kombëtar të mbrojtjes së territorit, si dhe mbikëqyrësin e punimeve në rastet kur kryhen punime në kundërshtim me lejen e ndërtimit/lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e të kontrollit të zhvillimit dhe me legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në republikën e shqipërisë. 3. drejtuesi i punimeve është pjesë e stafit të zbatuesit të punimeve i përcaktuar në licencën e shoqërisë.”

Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar, parashikon se: Kreu I “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës”.

KREU IV “Drejtuesi Teknik I Shoqërisë Dhe Papajtueshmëria Me Këtë Detyrë”

1. Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr. 5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 (pesë) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 (tre) vjet pas diplomimit në ciklin e dytë të studimeve universitare.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës, me afat të përcaktuar (jo më pak se 1 (një) vit).

2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit

Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike.

Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për kërkesë, si dhe dorëzimin e kopjes origjinale të këtyre licencave pranë arkivit të sektorit përgjegjës për licencimin, përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën.

Licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, i kthehet personit sapo ai shkëput marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë.

Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se “Kreu I, pika 2, Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, **sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.**

*Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, **përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.***

2.2 Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësi të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.

III.5.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik”, ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.5.10. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se, operatori ekonomik “BONUS” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar dokumentacionin e cituar në pikën III.5.3. (Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi nga operatori ekonomik “BONUS” SHPK, me datë 18.12.2024, licenca e subejktit, kontratë pune

me Ing. R.S, cv, diplomë, librezë pune si dhe Deklaratë për Drejtuesin Teknik datë 18.12.2024). Respektivisht, në shtojcën 8 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”. Në seksionin Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: *DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt - kontrate*”, ka pasqyruar punonjësit e nevojshëm sipas profileve të kërkuara, në përputhje me zërat e punimeve që do të kryejë secili sipas profileve përkatëse, ku ndër të tjera në përmbushje të pikës 2.3.6. kapacitetit teknik, ka deklaruar një punonjës Z. R.S., me profesion Ing. Ndërtimi, në rolin e Drejtuesit teknik, i përfshirë në licencën e shoqërisë, si edhe referuar deklaratës mbi Drejtuesin teknik, ky punonjës nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Para, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti fitues “BONUS” SHPK, Komisioni gjykon se, krieri i përcaktuar në pikën 2.3.6 të DT, konsiderohet i përmbushur. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik se ky drejtues teknik është i angazhuar edhe në kontrata të tjera të cilat janë në proces, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor, si organi përgjegjës për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, ka detyrimin të zbatojë me përpikëri të gjitha parashikimet ligjore, më qëllim mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës ku referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Gjithashtu, vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit për përmbushjen e kriterit 2.3.6, e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues BOE “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues) & “S.M.O.UNION” Shpk, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruktion i Rrugës ”Nënë Tereza” Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë, BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk edhe OE “BONUS” SHPK, referuar konstatimeve në këtë vendim duke i skualifikuar këta ofertues.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*COLOMBO*” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

